



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Numër: 2-1623
Datë: 23-08-2021

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 19/2018 Për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave mësimore, nxjerr:

V E N D I M

Për regjistrimin e qendrave mësimore

1. OJQ “Balkan Sunflowers Kosovo” në Plemetin-Obiliq, i jepet leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë në qendrën mësimore me bazë në komunitet – PBLC Plemetin-Obiliq learning Center për periudhën njërvjeçare, prej dt. 20.08.2021 deri me dt. 19.08.2022, me mundësi për riaplikim pas sigurimit të një objekti të përshtatshëm.
2. OJQ “Balkan Sunflowers Kosovo” në Plemetin-Obiliq, ushtron funksionin e saj konform Udhëzimit administrativ nr. 19/20218 Për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave Mësimore.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, bazuar në aplikimin dhe dokumentacionin e ofruar në formë elektronike nga qendra mësimore PBLC “Plemetin –Obiliq Learning center” në Plemetin-Obiliq, raportin e Komisionit për regjistrimin e qendrave mësimore të cilat mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; hapësirat ku ushtrohet veprimtaria në parim nuk janë për objekte standarde arsimore dhe janë hapësira të kufizuara, prandaj lejohet që të mësohet me numër të kufizuar në qendrën mësimore me bazë në komunitet. Niveli parashkollor dhe niveli fillor 1-5, puna me nxënës në të njëjtat objekte duhet të mbahet me numër të kufizuar në dhoma me grupe nga 10 nxënës, në 3 ndërrime me gjithsej 30 nxënës, dhe në funksion të zbatimit të Udhëzimit administrativ nr. 19/20218 Për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave mësimore si dhe bazuar në udhëzuesin për norma dhe standarde të ndërtesave shkollore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. OJQ-së “Balkan Sunflowers Kosovo”Plemetin -Obiliq;
2. Zyrës së SP;
3. Div.ars. të komuniteteve;
4. Arkivit.



Zv. e sekretare e përgjithshme